

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5827
E hënë, 15 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Mallrat e Serbisë pakësohen dukshëm në tregun e Kosovës



FAQE 8

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHEMSI SYLA | FAQE 4-5



Shtatori do të jetë vendimtar për fatin e kësaj qeverie

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Shemsi Sylja, ka vlerësuar se me këtë përbërje të qeverisë dhe me këtë formë të qeverisjes zhvillimet politike vetëm sa do të degradohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nuk ka asnjë mundësi që të ketë rezultat në ndonjë fushë.

Sipas Sylës, ky koalicion qeverisës punon sot për nesër dhe ka një moskoordinim total mes vete. Megjithatë, ai ka thënë se muaji shtator do të jetë vendimtar për fatin e kësaj qeverie. Sylja ka theksuar se në vjeshtë më parë do të ketë shpërbërje të Kuvendit sesa rrëzim të qeverisë përmes mocionit. Ai ka thënë se opozita e ka detyrë jetike rrëzimin e kësaj qeverie

AKTUALE

EKSPERTI AMERIKAN: NDRYSHIMI I KUFIJVE KOSOVË - SERBI U BLOKUA NGA MERKELI F. 5

DREJT FINALIZIMIT SHTATORJA E KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI F. 11

ILIR DUGOLLI: PALLATI I RINISË U RREZIKUA NGA FALIMENTIMI, GJENDJA TANI ËSHTË STABILIZUAR F. 7

EKONOMI




KOSOVA, MË PAK GRURË F. 9

DELEGACIONI I BQK-së TAKON ZËVENDËSDREJTORIN E FMN-SË NË SAMITIN E DUBROVNIKUT F. 9

KULTURË

'BALLKANI - DIPLOMACIA E MUNGUAR' F. 13



SPORT

SERMAXHAJ: FERONIKELI DO TA BËJË HISTORINË NË LIGËN E KAMPIONËVE F. 13

NJË TJETËR SFIDË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DREJT ANËTARËSIMIT NË INTERPOL

Për anëtarësimin e Kosovës në Interpol kërkohet lobim konkret



Njohësit e çështjeve të sigurisë kanë treguar se çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për anëtarësimin në Interpol. Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë për

gazetën "Epoka e re" se për të arritur këtë qëllim duhet bërë lobim konkret dhe pa shumë bujë. Sipas tij, duhet të punohet me shtetet të cilat herën e kaluar kanë votuar kundër anëtarësimin të Kosovës në

këtë organizatë, për të parë se pse kanë vepruar në këtë mënyrë. Ndërkaq ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i ka bërë ftesë Serbisë që të mos i bëjë Kosovës obstrukcione në këtë rrugë | FAQE 3



Policia ka shpërndarë mbi 33 mijë fletushka për parandalimin e drogave

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com
044/256-051
044/367-061
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Berisha e Mediu takojnë këshilltarin e presidentit Trump

TIRANË, 14 KORRIK - Kreu i republikanëve shqiptarë Fatmir Mediu ka bërë publik detaje të një takimi zhvilluar të dielën në Tiranë mes ish-kryetarit të Bashkisë së Nju Jorkut Rudi Guiliani dhe avokat personal i presidentit amerikan, si dhe ish-Sekretarit për Homeland Security Tom Ridge me ish-kryeministrin Berisha. "Takim dhe mëngjes pune me

këshilltarin e presidentit Trump, ish-kryetarin e Bashkisë së Nju Jorkut Rudi Guiliani, ish-Sekretarin për Homeland Security Tom Ridge dhe ish-kryeministrin Sali Berisha", ka shkruar Mediu.

Diskutimi u përqendrua rreth krizës politike në Shqipëri, krimin, korrupsionit dhe shkatërrimi i lirive të qytetarëve shqiptarë prej

kryeministrin Rama.

Ky takim vjen në një moment shumë të vështirë për demokracinë dhe situatën politike në Shqipëri.

Natyrisht që Rudi Guiliani dhe Tom Ridge janë njerëzit e besuar të presidentit Trump. Ndaj shpresohet se ata do t'i raportojnë saktësisht presidentit për situatën në Shqipëri.



Rama paralajmëron ndryshime në qeveri

Meqë vjeshta do jetë realisht e nxehtë prej opozitës e cila nuk ka më se ç'të humbasë e ku protestat do jenë radikale, mësohet se Edi Rama mund të japë dorëheqjen dhe do merret me PS-në në zgjedhjet e parakohshme si dhe për t'i hequr opozitës një armë të saj publike, ku ka deklaruar se nuk do të pranojë Ramën kryeministër në zgjedhje

TIRANË, 14 KORRIK - Me sa duket kryeministri po përgatitet për zgjedhje të parakohshme parlamentare, si një mënyrë për të ulur tensionin politik, ndaj disa figura ministore do t'i kalojnë në selinë rozë për t'i pasur në fushatën e pritshme për në tetor ose në mars-prill të vitit të ardhshëm.

Burimet thonë se ikën ministrja e drejtësisë Etilda Gjonaj, e cila zëvendësohet nga Spartak Ngjela. Kalimi i avokat Ngjelës në postin e ministrit të Drejtësisë vjen si pasojë e luftës politike e cila do të jetë shumë e ashpër sapo të fillojë vjeshta. Spartak Ngjela duke qenë hapur ndaj Metës, Bashës dhe Berishës do jetë krahu i djathtë i kryeministrin në sulmet ndaj tyre. Ndaj roli i tij do jetë në sulmet politike dhe në media, pasi ministrat dhe ish-ministrat e tjerë kanë dështuar në duelet

politike. Për të bërë punën në Ministrinë e Drejtësisë, kryeministri ka menduar ta dublojë Spartak Ngjelen me dy zëvendësministra, ndërkohë që Ngjela do jetë në detyrën që bën më mirë, te sulmet politike. Po kështu ikën Pandeli Majko. Qëndrimet e tij publike dhe disa qëndrime me spirale karrikeriste kur donte t'i zinte vendin kryeministrit, e kanë bërë dyshues në mendjen e Edi Ramës. Ai shkon drejt venitjes, pasi në zgjedhjet e radhës nuk do ta kandidojë, sikurse ka ndërmend për Ditmir Bushatin dhe Fatmir Xhafën, pavarësisht se të tre janë ikona të PS-së. Rama e ka të qartë në kokën e tij se kush duhet palosur nga selia e PS-së për çdo rast rreziku që mund t'i vijë karrigës së tij politike. Përherë Pandeli Majko mbetet rrezik serioz për të, sepse ka dhënë prova dy



herë si ish-kryeministër sa herë kishte kriza të forta politike. Dhe prapë Majko rri me çelësa në dorë për ta marrë për të tretën herë zyrën e qeverisë, aq me tepër që opozita e pranon si kryeministër që nuk prek zgjedhjet.

Blendi Klosi rrezikon seriozisht këtë herë, sidomos pas kritikës së Ramës se është parë me Fahri Balliun, botuesin e gazetës 55, duke pirë kafe. Nuk ka asnjë logjikë kjo, por kështu kanë shkruar punët në PS. Me sa duket i është prerë bileta për të ikur. Dhe në grupin parlamentar po fërkojnë duart për t'i zënë karrigen e ministrit.

Ndërsa Sandër Lleshi ndërron vendin me Olta Xhaçkën. Kjo me sa kuptohet vjen për të larguar imazhin negativ të ministrit të Brendshëm në raport me përdorimin e gazit masiv ndaj opozitës. Olta Xhaçka mbetet një figurë më emblematike dhe e pa akuzuar. Aq me tepër një femër në krye të Ministrisë së Brendshme i jep me civilizim kësaj ministrie të kthyer në një fabrikë gazi helmues. Ogerta Manastirliu nuk lëviz, pasi ka kryer reforma shëndetësore korrekte, sipas mazhorancës.

Në vend të Pandeli Majkos kryeministri ka menduar të sjel-

lë një tjetër kosovar në krye të Ministrisë së Diasporës. Flitet për një intelektual të njohur kosovar, që edhe shkruan, por burimet thanë se mbetet në dilemë Edi Rama.

Meqenëse vjeshta do jetë realisht e nxehtë prej opozitës e cila nuk ka më se ç'të humbasë e ku protestat do jenë radikale, mësohet se Edi Rama ka një plan rezervë. Mendohet se mund të japë dorëheqjen. Dhe do merret me PS-në në zgjedhjet e parakohshme si dhe për t'i hequr opozitës një armë të saj publike, ku ka deklaruar se nuk do të pranojë Ramën kryeministër në zgjedhje.

Burimet thanë se mund të caktojë Erjon Braçen si kryeministër zgjedhesh ose një femër ministre, por se cilën është e vështirë të mësohet emri tani për tani. Burime të tjera tregojnë se nga natyra Rama nuk i beson askujt.

Ai e di se po i rrëshqiti këmba, të nesërmen nuk i hapin telefonat ministrat më të afërt. Dihet rasti i Fatos Nanos ku sapo iku nga kryeministër nuk i hapte telefonin as një ish-ministër.

Megjithatë qeveria po ndryshon, ndërkohë opozita synon ta fshijë krejt qeverinë me Ramën.

Basha: Beteja e opozita do të vazhdojë me standarde perëndimore

TIRANË, 14 KORRIK - Lideri demokrat duket se është zbutur pas zgjedhjeve të 30 qershorit dhe paralajmërimëve ndërkombëtare për dhunën dhe molotovin në protesta, duke përdorur një gjuhë më të moderuar për betejën e opozitës kundër qeverisë, ku tashmë flet për standarde evropiane dhe amerikane.

Në një takim me delegacionin amerikano-hebre, Basha ka deklaruar se beteja e opozitës do të vijojë me standarde

perëndimore. "Në vend të heshtjes apo dorëzimit para modelit të dështuar të despotizmit lindor, korrupsionit dhe shkatërrimit të lirisë dhe demokracisë, ne do të vazhdojmë pa kompromis me standartet evropiane dhe amerikane, betejën tonë deri në triumfin e vlerave të përbashkëta perëndimore të lirisë, demokracisë dhe mundësive për çdo shqiptar", deklaroi Basha në takim me delegacionin e Komitetit Amerikano-Hebraik

ACJ, të kryesuar nga drejtori ekzekutiv, David Harris.

Basha tha se i ka shprehur Harris shqetësimin dhe domosdoshmërinë për ta vazhduar betejën "në këtë orë të errët në Shqipëri, për vlerat dhe parimet themelore të zgjedhjeve të lira, barazisë para ligjit dhe ndarjes dhe kontrollit të pushteteve".

Aktualisht, Basha ka ndalur turin e protestave dhe po merret me problemet e partisë, ku vetëm një ditë me herët ndryshoi koordinatorët e degëve të PD-së.



Një tjetër sfidë e Republikës së Kosovës drejt anëtarësimit në Interpol

Për anëtarësimin e Kosovës në Interpol kërkohet lobim konkret

Njohësit e çështjeve të sigurisë kanë treguar se çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për anëtarësimin në Interpol. Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se për të arritur këtë qëllim duhet bërë lobim konkret dhe pa shumë bujë. Sipas tij, duhet të punohet me shtetet të cilat herën e kaluar kanë votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë, për të parë se pse kanë vepruar në këtë mënyrë. Ndërkaq ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë ftesë Serbisë që të mos i bëjë Kosovës obstrukcione në këtë rrugë

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 KORRIK - Komiteti Ekzekutiv i Interpolit e ka dërguar dosjen e Policisë së Kosovës për votim në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, e cila këtë vit do të mbahet në Kili, ndërsa njohësit e çështjeve të sigurisë kanë bërë me dije se institucionet e vendit duhet të punojnë shumë për ta arritur anëtarësimin në Interpol.

Njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se duhet të bëhet lobim konkret për anëtarësimin në Interpol. "Duhet bërë lobim konkret pa shumë bujë dhe harxhime me shtetet që tanimë i dimë se cilat janë dhe pse kanë hezituar të votojnë herën e kaluar. Pastaj janë edhe disa shtete të vogla të cilat edhe kërkojnë inkurajim shtesë për të qenë në mbledhje meqë zakonisht mungojnë. Pra, kërkohet shumë punë konkrete dhe hiç lajme për lavdi", ka thënë Selimi.

Ai ka përmendur faktorët që mund të ndikojnë në këtë rrugëtim të Kosovës. "Vështirë të parashikosh meqë është çështje politike dhe e varur nga vullneti individual i secilit shtet anëtar. Pastaj ndikimi ruso-serb në këtë organizatë, bashkë me Kinën, nuk është i vogël. Pra, kushdo që e trajton këtë temë duhet ta ketë

parasysh se është një OKB në miniaturë, duke përfshirë edhe raportin e forcave politike dhe ndikimet e tyre në vendimmarrje", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova tashmë përbush të gjitha kushtet për të qenë pjesë e kësaj organizate.

Sipas Selamit, Kosova i ka dhënë shumë Interpolit deri më tani.

"Ajo në çka jam i sigurt është se shteti ynë i përbush të gjitha kriteret për anëtarësim dhe tash e sa vjet nëpërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it i ka ndihmuar shumë kësaj organizate për arritjen e qëllimeve të saj. Pra, ne i kemi dhënë shumë Interpolit ende pa qenë anëtar. Sidoqoftë, brenda kësaj organizate ka

ndikim", ka deklaruar ish-drejtori i Policisë së Kosovës.

Ndërsa zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, pasi Komiteti Ekzekutiv i Interpolit e ka dërguar dosjen e Policisë së Kosovës për votim në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, ka deklaruar se Policia e Kosovës është cilësuar në nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe kredibilitetit si organizatë policore moderne dhe me standarde të avancuara.

Ai i ka bërë ftesë Serbisë që të mos i bëjë Kosovës obstrukcione në këtë rrugë. "Urojmë që Serbia t'i thërrasë zërit të arsyes dhe të mos veprojë me obstrukcionet e saj kundër paqes dhe sigurisë. Do të ishte primitive dhe jashtë çdo logjike pengimi dhe lobimi

kundër anëtarësimit të Policisë së Kosovës në organizatën ndërkombëtare të Interpolit, në anën tjetër të flasësh për paqe dhe siguri", ka thënë Pacolli.

Në fund të muajit të kaluar Komiteti Ekzekutiv i Interpolit me seli në Lyon të Francës ka debatuar rreth aplikacionit të Republikës së Kosovës dhe vendosi në favor të dërgimit të dosjes së Policisë së Kosovës për votim në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, e cila këtë vit do të mbahet në Kili.

Më 20 nëntor të vitit 2018 Kosova nuk kishte arritur të anëtarësohet në Interpol, pasi që nuk mori shumicën e nevojshme, prej dy të tretave të votave të vendeve pjesëmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate, që u mbajt në Dubai.



Veseli në ShBA, me ftesë të Kongresit Amerikan



PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, me ftesë të Kongresit Amerikan, ka udhëtuar të dielën për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë kësaj vizite në Uashington, kryeparlamentari Veseli do të zhvillojë takime me përfaqësues të rëndësishëm të shtetit amerikan, senatorë, kongre-

sistë dhe aktorë të tjerë të jetës publike në ShBA.

Në këto takime do të flitet për bashkëpunimin dhe miqësinë midis dy shteteve dhe popujve tanë, për mbështetjen e mëtejme amerikane në funksion të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, por edhe të rritjes së kapaciteteve shtetërore të saj.

Në një ngjarje të veçantë, e cila do të organizohet në Kongresin Amerikan, kryeparlamentari Veseli do të mbajë fjalim para drejtuesve të shumtë të parlamenteve nga vende të ndryshme të botës.

Pjesë e delegacionit të kryeparlamentarit Veseli në këtë vizitë zyrtare janë edhe deputetët Mimoza Kusari-Lila dhe Avdulla Hoti.

Flet për "Epokën e re", Shemsi Syla

Shtatori do të jetë vendimtar



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Shemsi Syla, ka vlerësuar se me këtë përbërje të qeverisë dhe me këtë formë të qeverisjes zhvillimet politike vetëm sa do të degradohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nuk ka asnjë mundësi që të ketë rezultat në ndonjë fushë. Sipas Sylës, ky koalicion qeverisës punon sot për nesër dhe ka një moskoordinim total mes vete. Megjithatë, ai ka thënë se muaji shtator do të jetë vendimtar për fatin e kësaj qeverie. Syla ka theksuar se në vjeshtë më parë do të ketë shpërbërje të Kuvendit sesa rrëzim të qeverisë përmes mocionit. Ai ka thënë se opozita e ka detyrë jetike rrëzimin e kësaj qeverie

"Epoka e re": Pavarësisht prej premtimeve, Kosova vazhdon të mos ketë liberalizim të vizave. Po ashtu, në këta dy vjet ka pasur ngecje të njohjeve dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Pse mendoni se po ndodh një gjë e tillë?

Syla: Sa i takon liberalizimit të vizave duhet të jemi korrektë, nuk është i gjithë faji i qeverisë. Në kuadër të BE-së, Kosovën nuk e kanë njohur pesë shtete, kjo ka ndikuar shumë që brenda BE-së të mos ketë konsensus për liberalizimin e vizave. Duke munguar ky konsensus brenda BE-së, zyrtarët e Brukselit, duke e parë që Kosova përfaqësohet nga njerëz që nuk janë në gjendje të argumentojnë e ta mbrojnë plotësimin e kushteve për liberalizim, kanë shtuar edhe kushte

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 14 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Syla, si jeni duke i parë zhvillimet politike në vendin tonë? Sa jeni optimist se Kosova mund të ecë në rrugën e duhur?

Syla: Me këtë përbërje të

qeverisë dhe me këtë formë të qeverisjes zhvillimet politike vetëm sa do të degradohen. Nuk ka asnjë mundësi që të ketë ndonjë rezultat në ndonjë fushë. Ky koalicion qeverisës punon sot për nesër dhe pushtetin e ka shndërruar në feude, ku secili subjekt politik bën çfarë të dojë me ministrinë

të cilat udhëheq, kemi një moskoordinim total. E në vllugun e këtij mishmashi qeverisës, tash ka edhe akuza e kundërakuza publike ndërmjet partnerëve të koalicionit. Dëm i madh i është shkaktuar Kosovës, sidomos në politikën e jashtme. Emërimet e ambasadorëve dhe stafit diplo-

matik janë vërshuar nga militantët partiakë pa asnjë dije dhe përgatitje sa i takon përfaqësimit të shtetit dhe njohjes profesionale të diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Për herë të parë që nga pavarësia, Kosova nuk ka qëndrim unik as sa i takon dialogut me Serbinë.

për fatin e kësaj qeverie

nga fillimi i punës së kësaj qeverie e cila doli nga një koalicion që synim e kishte fitimin e pushtetit e jo programin qeverisës për zhvillim e avancim të shtetit. Pra, kemi pasur dhe kemi një qeveri pa program dhe pa prioritet. Siç dihet, koalicioni parazgjedhor ndërmjet PDK-së, AAK-së e Nismës u formua duke bërë pazare me poste. Po mos t'i ofrohej posti i kryeministrit Haradinajt nuk do të kishte koalicion fare ndërmjet këtyre subjekteve politike, prandaj nuk kemi asnjë zhvillim në asnjë fushë, por vetëm përkeqësim në arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik e ç'akordim total në politikën e jashtme. Pra, kemi një qeveri që e ka shumëfishuar nepotizmin e klientelizmin në çdo institucion, kurse korrupsionin e ka institucionalizuar deri në atë shkallë sa vidhet publikisht dhe askush nuk ndëshkohet. Po ashtu, edhe puna e Kuvendit të Kosovës ka shënuar rënie drastike. Ka qenë praktikë që gjatë javës, çdo të enjte, të ketë seanca të rregullta parlamentare. Kjo praktikë e punës ka dy mandate që nuk përfillen fare por, në këtë mandat, për çudi, më shumë kemi seanca të jashtëzakonshme sesa seanca të rregullta ku diskutohet e aprovohen ligje. Derisa opozita ishte shumë e fuqishme në fillim, dalja e grupit të deputetëve nga radhët e Vetëvendosjes dhe formimi i Partisë Socialdemokrate e dobësoi në radhë të parë Vetëvendosjen si subjekt politik sa i takon përfaqësimit dhe fuqisë parlamentare, gjithashtu krijoi një hendek edhe brenda vetë opozitës. Megjithatë, kohët e fundit kemi një përafrim të qëndrimeve edhe brenda subjekteve opozitare dhe një presion në rritje në raport me pozitën dhe keqqeverisjen në vend. Opozita ka kundërshtuar çdoherë ligjet e vendimet e këqija, por nuk ka pasur numra për t'i penguar ato në shumë raste. Aktualisht, opozita ka një detyrë jetike gjatë këtyre muajve: rrëzimin e kësaj qeverie. Nëse e arrin këtë, i bëhet një shërbim shumë i madh Kosovës.

"Epoka e re": Opozita është duke u përhapur që t'i sigurojë votat për ta rrëzuar këtë qeveri dhe ka shpresa që kjo të ndodhë në shtator. Do të mund të realizohet ky skenar?

Syla: Në këtë gjendje ku ndodhet Kosova, opozita ka një detyrë jetike: që gjatë këtyre muajve, përmes votëbesimit, ta rrëzojë këtë qeveri. Nëse e arrin këtë, i

bëhet një shërbim shumë i madh Kosovës. Me shumë gjasë, muaji shtator do të jetë vendimtar sa i takon fatit të kësaj qeverie. Siç po shihet, edhe brenda vetë koalicionit qeverisës ka mosmarrëveshje dhe ftohje të raporteve. Qeveria është duke mbijetuar jo falë rezultateve dhe punës që po bën, por falë frikës së humbjes së pushtetit. Haradinaj po mendon se ka krijuar disa adute të forta gjatë qeverisjes që do t'i shpërblehen me votë, në rast se ka zgjedhje. Arritje e madhe po i duket sidomos vendosja e taksës ndaj produkteve serbe. PDK-ja po frikësohet nga zgjedhjet sepse ka humbur shumë vota dhe nuk është në garë për të dalë partia e parë, po përpiqet që ta përmirësojë imazhin e saj përmes premtimeve populiste dhe është në kërkim të partnerëve për një koalicion parazgjedhor. Nisma, nga ana tjetër, me mjeshtëri po e luan rolin e viktimës si pjesë e këtij koalicioni duke theksuar se është bërë pa dëshirën e saj dhe herë pas here jep shenja pakënaqësie dhe kërcënim për prishje të koalicionit. Në fakt, të tria: PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma

po sillen si të viktimizuara karshi opinionit publik, por hajninë e korrupsionin i kanë të përbashkëta natë e ditë. Duke pasur parasysh mungesën e numrave të opozitës dhe kalkulimet që mund të ndodhin brenda partive opozitare, unë mendoj se në vjeshtë më parë do të kemi shpërbërje të Kuvendit sesa rrëzim të qeverisë përmes mocionit. Shpërbërja e Kuvendit do të ndodhë në mënyrë që partitë që janë në koalicionin qeverisës ta ruajnë një lloj bashkëpunimi, sepse shpërbërja e Kuvendit nuk është goditje ndaj kryeministrit, por një shpërndarje e fajësisë dhe keqqeverisjes. Argumenti do të jetë se Kuvendi nuk është funksional. Pozitës i mungojnë numrat, prandaj funksionimi normal është bërë i pamundshëm.

"Epoka e re": Z. Syla, vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka kthyer në pikën zero dialogun me Serbinë. Si e shihni tash e tutje vazhdimin e këtij procesi? Prisni që në vjeshtë të ketë një dialog me rezultate konkrete?

Syla: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka kthyer në

pikën zero ekipin negociator, jo dialogun. Dialog gjithsesi do të ketë, por për vazhdimin e tij po ndikojnë disa faktorë. Sa i takon dialogut, kemi konfrontim të hapur president - kryeministër, që do të thotë edhe dy opsione: Asociacion me kompetenca ekzekutive apo shkëmbim terroresh. Në anën tjetër, ende nuk dihet cili do të jetë fati i kësaj qeverie dhe as faktori ndërkombëtar nuk e ka besimin e mjaftueshëm se kjo klasë politike mund të dialogojë suksesshëm fatin e shtetit që e përfaqëson. E derisa kemi një bllokim të dialogut nga të dyja palët, lobimet për gjetjen e një zgjidhjeje ndërmjet Kosovës e Serbisë po vazhdojnë. Aktualisht janë dy opsione: Asociacioni apo shkëmbimi i terroreve. Ky lidhshmëri aktual nuk ka opsion të tretë. Nëse do të ketë zgjedhje të parakohshme në Kosovë dhe nëse partitë opozitare arrijnë që ta fitojnë pushtetin, atëherë do të kemi edhe qartësim të pozicionit të Kosovës karshi dialogut, por edhe qasje krejt ndryshe sa i takon marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Eksperti amerikan: Ndryshimi i kufijve Kosovë - Serbi u bllokua nga Merkeli

PRISHTINË, 14 KORRIK - James Hooper, ish-zyrtar i Departamentit të Shtetit dhe ekspert me përvojë i Ballkanit, ka thënë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë nuk mund të mos ta ketë elementin e territorit. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Hooper ka deklaruar se ka qenë kancelarja gjermane Angela Merkel dhe kryeministri Ramush Haradinaj që bllokuan shkëmbimin e terroreve Kosovë - Serbi që ishte negociuar nga presidentët Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq. "Presidentët Thaçi dhe Vuçiq po negocionin një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe arsyeja që ajo dështoi ishte në fakt jo se serbët dhe shqiptarët nuk mund të binin dakord. Në fakt, ishin shumë pranë marrëveshjes. Sigurisht duheshin sqaruar disa



detaje, por në përgjithësi, për konceptin e përgjithshëm kishin rënë dakord. Problemi ishte se populli i Kosovës nuk donte të pranonte një shkëmbim territori si pjesë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse. Po ashtu, as Gjermania, zonja Merkel, nuk donte ta pranonte dhe kështu e bllokoi. Unë e kuptoj shumë mirë ndjeshmërinë që mund të kenë gjermanët për papreksh-

mërinë e kufijve dhe territorit që vijnë nga Lufta e Dytë Botërore dhe Lufta e Ftohtë, por kjo nuk funksionon në Ballkan, atje është ndryshe", ka deklaruar eksperti amerikan. Hooper ka thënë se situata e krijuar kërcënon stabilitetin dhe se Shtetet e Bashkuara e kanë vullnetin të angazhohen, por duan ta shohin perspektivën për një zgjidhje.

të tjera që në parim nuk kanë asnjë lidhje me lëvizjen e lirë. Por këtij kalkulimi të BE-së natyrisht se i ka ndihmuar shumë keqqeverisja e sidomos rritja e korrupsionit e kapja e sistemit të drejtësisë nga politika. Kjo qeveri, edhe pse i ka paraparë BE-ja për liberalizimin e vizave, duke e trashur korrupsionin e duke pasur kontroll absolut në sistemin e drejtësisë, e ka përligjur hezitimin e disa vendeve për të mos dhënë pëlqimin për liberalizim të vizave.

"Epoka e re": Çfarë vlerësimi keni për këta gati dy vjet të qeverisjes dhe për punën e Kuvendit si dhe rolin e opozitës?
Syla: Në shtator bëhen dy vjet

Muzafer Shala, ministër i ri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka propozuar Muzafer Shalën për postin e ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, pasi më 20 qershor Besim Beqaj është larguar nga ky post me pëlqimin e Veselit, i cili ka marrë vendim që të gjithë zyrtarët e kësaj partie që kanë aktakuza t'i lirojnë pozitat në institucionet e Kosovës



vetmja parti që jep mundësi reale për njerëzit e rinj dhe premtues", ka thënë Veseli, duke shtuar se PDK-ja do të vazhdojë të promovojë njerëz të rinj. "Ne do ta vazhdojmë luftën tonë të pakompromis kundër korrupsionit dhe

jam i bindur se bashkë me Muzaferin dhe të tjerët do ta udhëheqim Kosovën suksesshëm në 'Dekadën e Re'", ka thënë Veseli.

Më 20 qershor Besim Beqaj është larguar nga posti i ministrit të

Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me pëlqimin e liderit të PDK-së, Kadri Veseli, i cili ka marrë vendim që të gjithë zyrtarët e kësaj partie që kanë aktakuza t'i lirojnë pozitat në institucionet e Kosovës.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, në fundjavë ka prezantuar ministrin e ri të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shalën, i cili është doktor shkence në fushën e Inxhinierisë Elektronike në Universitetin e KENT-it, i cili është një ndër universitetet më të mira në Angli.

Muzafer Shala është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe vjen nga Dega e PDK-së në Vushtrri.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë gjatë prezantimit të ministrit të ri se inovacioni dhe ndërmarrësia janë elementet kryesore të ekonomisë që synon Kosova. "Një nga parimet kryesore për të krijuar ndërmarrësi dhe inovacion është bashkëpunimi adekuat në mes të industrisë dhe botës akademike, së bashku me zhvillimin e kapitalit njerëzor. Ne kemi shumë njerëz premtues në Kosovë. Fatkeqësisht shumë prej tyre po e lëshojnë vendin. Qëllimi ynë është që ta ndalim zbrazjen e trurit dhe t'i japim rinisë sonë

arsye për të qëndruar këtu. Një mjedis që i siguron rinisë sonë kushte dhe programe për t'i realizuar ëndrrat e veta, për t'i implementuar idetë e tyre inovative - definitivisht do t'i bindë ata për të qëndruar. Ky është misioni ynë", ka deklaruar Veseli. Ai ka pohuar se ministri i ri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka potencial për ta bërë bashkëpunimin e duhur ndërmjet botës akademike dhe industrisë nga njëra anë, si dhe për t'ua ofruar të rinjve kushtet e nevojshme dhe mjedisin e përshtatshëm nga ana tjetër, në mënyrë që të sendërtohen ëndrrat e tyre.

Kreu i PDK-së ka thënë se emërimi i Muzafer Shalës në pozitën e ministrit po ashtu dërgon mesazhin e duhur se PDK-ja ua jep hapësirën meritore njerëzve të rinj dhe premtues. "Do të ketë edhe më shumë hapësirë në politikën tonë për njerëzit e shkathhtë dhe të talentuar, dhe pikërisht PDK-ja është platforma e tyre. Njerëzit premtues që duan t'i shfrytëzojnë cilësitë e veta intelektuale, profesionale dhe morale, për ta zhvilluar e promovuar shtetin tonë, do ta kenë vendin meritore në PDK. PDK-ja është e

Kush është Muzafer Shala?

Muzafer Shala është i doktoruar në fushën e Inxhinierisë Elektronike në Universitetin e KENT-it i cili është një ndër universitetet më të mira në Angli. Është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe vjen nga Dega e Partisë Demokratike të Kosovës në Vushtrri. Ai ka përvijë 17-vjeçare në fushën e edukimit në Kosovë dhe një periudhë të shkurtër edhe në Angli. Krahas mesimdhënies, ka pasur edhe pozita menaxheriale si të koordinatorit për

Zhvillim Akademik, dekan i Fakultetit të Mekanikës dhe Dekan i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike. Kohë pas kohe ka punuar edhe në industri në sektorin e sistemeve të kontrollit automatik. Që nga viti 2016 punon mesimdhënies i rregullt në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" si dhe në Kolegjin Universum në Prishtinë. Muzafer Shala është i lindur më 12 tetor 1980 në Vushtrri, është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Kryetari i Kamenicës tregon arsyen pse emëroi 21-vjeçarin Sinbad Sonkin drejtor të Financave

KAMENICË, 14 KORRIK (ER) - Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka treguar arsyen pse ka emëruar Sinbad Sonkin nga komuniteti rom drejtor të Financave në këtë komunë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se emërimi i Sonkit në pozitën e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është realizim i qëllimit të tij si kryetar komune dhe pasqyrim i vlerave për qeverisje për qytetarin pa dallim, gjithëpërfshirje dhe avancim të komunitetit drejt zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror. "Z. Sonki nuk është çfarëdo qytetari, çfarëdo i ri, çfarëdo punëtori. Sonki vjen nga një komunitet që jeton në kushte mizore në Kosovë prej kur mbajmë mend. Komuniteti rom ka vuajtur nga varfëria, mungesa e arsimit, problemet shëndetësore, martesat e hershme, dhuna në familje, mungesa e perspektivës dhe



diskriminimi i vazhdueshëm. Numrin e problemeve dhe dimensionet i dimë të gjithë. Por, vazhdojmë t'i neglizhojmë

në të gjitha nivelet. Këto janë aspektet më të rëndësishme të këtij rast emërimi. E kur kalojmë vëmendjen tonë nëpër këto

aspekte, jam i bindur që gjithsecili e ndien nevojën për veprim", ka shkruar Kastrati. Ai ka thënë se Sinbad Sonki

është njeriu më i përshtatshëm në komunitetin rom në Kamenicë për të qenë drejtor. "Zellin për punë e gatishmërinë për angazhim ia kemi vërejtur Sinbadit gjatë kohës kur e ka vijuar kursin për mesimin e gjuhës shqipe. Dua t'ju siguroj se Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka stafin më të përgatiturin. Aty ka miqësi, atmosferë pune dhe sistem të vendosur. Asgjë nuk do të mbetet pa u kryer, performanca veçse do të rritet. Unë marrë përgjegjësi për këtë. Në anën tjetër, të gjitha drejtoritë janë të rëndësishme. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka barrën e sjelljes së investimeve, trajtimit të turizmit e diasporës. Arsimit edukon gjeneratat e ardhshme. Shëndetësia përmirëson shërbimet shëndetësore. Por, vendimi ynë ka qenë i mirëmenduar duke i marrë parasysh të gjitha aspektet që i përmenda më lart", ka thënë kryetari Kastrati.

Policia ka shpërndarë mbi 33 mijë fletushka për parandalimin e drogave

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se gjatë këtij viti policia ka mbajtur aktivitete në fushën e parandalimit të drogave në shkolla dhe jashtë shkollave. Ai ka treguar se policia ka shpërndarë mbi 33 mijë fletushka për parandalimin e drogave në shkolla dhe jashtë shkollave



së Kosovës, Rashit Qalaj, ka treguar se vetëm në këtë vit janë arrestuar 984 persona të dyshuar për përdorim të drogës, në mesin e tyre 194 nxënës. Ai ka bërë me dije se gjatë këtij viti policia ka mbajtur shumë aktivitete në fushën e parandalimit të drogave në shkolla dhe jashtë shkollave. Sipas tij, policia ka shpërndarë mbi 33 mijë fletushka për parandalimin e drogave. "Aktiviteti ka qenë shumë i madh në fushën e parandalimit të drogave në shkolla dhe jashtë shkollave. Për parandalimin e këtyre dukurive jemi marrë me shumë aktivitete dhe kemi bërë shpërndarjen e fletushkave. Janë arrestuar 984 persona, 194 nxënës, 790 nuk

kanë qenë nxënës. Janë bërë 31 mijë e 125 vizita kontakte në shkolla, janë kontrolluar 68 mijë persona dhe janë kontrolluar 36 mijë e 659 vetura. Janë mbajtur 565 ligjërata në shkolla dhe mbi 33 mijë fletushka u janë shpërndarë nxënësve", ka thënë Qalaj. Ndërkaq shefi i Task-Forcës Shtetërore për Antidrogë dhe Siguri në Shkolla, Avdullah Hasani, ka thënë se qëllimi i formimit të kësaj Task-Force është mbrojtja e të rinjve nga përdorimi i drogave. "Task-Forca u krijua duke u bazuar në nevojën dhe kërkesën e kryeministrit që institucionet të ofrojnë siguri për të rinjtë. Qëllimi i formimit të Taks Forcës është mbrojtja e të rinjve nga përdorimi i drogave", ka thënë Hasani. Zëvendëskryeprokuroja Sevdije Morin ka thënë se gjatë vitit 2019 prokuroritë kanë trajtuar 511 raste të të dyshuarave për përdorim të drogës. "Gjatë vitit 2019 prokuroritë kanë pranuar 511 raste. Prokurori i Shtetit ka për detyrë hetimin dhe ndjekjen e veprave penale. Ne merremi edhe me parandalimin e veprave penale, prokuroria përpiqet në forma të ndryshme për dukuritë të cilat shkatërrojnë shoqërinë tonë. Sa i përket luftës kundër

narkotikëve, prokuroritë kanë bërë një punë të madhe dhe shpresoj që nga ky takim të dalim me një qëndrim të përbashkët dhe të flasim për gjera pozitive", ka thënë Morina. Kurse ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se janë të angazhuar që me bashkëpunim të krijojnë një vend më të sigurt për fëmijët. "E mira e kësaj Task-Force është se po bëjmë një bashkëpunim të përbashkët ku fëmijët tanë do të kenë një vend të sigurt. MMPS-ja ka bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës", ka thënë ai.

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 KORRIK - Javën e kaluar është mbajtur takimi konstitiiv i Task-Forcës kundër drogës dhe sigurisë në shkolla. Në këtë takim ishin të pranishëm ministri, zëvendësministri, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, zëvendëskryeprokuroja e Shtetit, Avokati i Popullit, të cilët e informuan Task Forcën lidhur me aktivitetet e deritanishme dhe masat që propozojnë të zhvillohen në kuadër të Task Forcës dhe fushatës kundër narkotikëve të rinjtë.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë



Ilir Dugolli: Pallati i Rinisë u rrezikua nga falimentimi, gjendja tani është stabilizuar

PRISHTINË, 14 KORRIK - Pas shumë problemeve që kishin punëtorët e Pallatit të Rinisë me pagat, me ndihmën e Komunës së Prishtinës tashmë i janë kthyer gjendjes së normalitetit. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Pallatit të Rinisë, Ilir Dugolli, ka thënë se Komuna e Prishtinës i ka ndarë 3 milionë e 757 mijë euro subvencion dhe punëtorët kanë marrë pagat e tyre. "Gjendja në Pallatin e Rinisë nuk qëndron keq, punëtorët e Pallatit të Rinisë tashmë i janë kthyer normalitetit prej kur komuna i ka ndarë subvencionin prej 3 milionë e 757 mijë eurosh, tashmë edhe si ndërmarrje dhe si organizatë i jemi kthyer normalitetit", ka thënë Dugolli për "EkonomiaOnline".

Ai ka theksuar se një gjendje e tillë siç ka qenë më parë me punëtorët e Pallatit nuk do të përsëritet dhe Ndërmarrja Shoqërore Kulturore Sportive dhe Ekonomike (QSHKSE) me rastin e kalimit në kompetencat e komunës është dashtë të

bartet si Ndërmarrje Publike Lokale. "Me regjistrimin e ndërmarrjes nuk ka ndodhur diçka e papritur, nga një ndërmarrje shoqërore, qysh ka qenë Ndërmarrja Shoqërore Kulturore Sportive dhe Ekonomike (QSHKSE) tani me rastin e kalimit në kompetencat e komunës është dashtë të bartet si Ndërmarrje Publike Lokale", ka thënë ai. Sipas Dugollit, Pallatit të Rinisë i ishte ekspozuar edhe një rrezik i madh që të hiqet nga regjistri i ndërmarrjeve shoqërore. "Gjendja e palakmueshme ka qenë e punëtorëve të Pallatit të Rinisë sepse Pallatit i është ekspozuar një rrezik i madh që të hiqet nga regjistri i ndërmarrjeve shoqërore. Do të thotë ka qenë një rrezik i paparashikueshëm i bankrotimit. Me Komunën e Prishtinës kemi komunikim të mirë dhe jemi në harmonizim me veprimet të cilat duhet t'i ndërmarrim si komunë dhe si ndërmarrje publike, sepse aksionare është



Komuna e Prishtinës dhe është pronë e Komunës së Prishtinës", është shprehur Dugolli.

Se protestat kanë qenë legjitime dhe të arsyeshme, e thotë vetë Dugolli, pasi kanë pasur efekt që punëtorët e Pallatit të Rinisë t'i marrin pagat e tyre. "Nuk e besoj që do të përsëritet një

gjendje e tillë që ka qenë me punëtorët e Pallatit dhe ndërmarrjeve, përndryshe protestat kanë qenë shumë legjitime dhe shumë të arsyeshme për t'i marrë punëtorët e Pallatit të Rinisë pagat e tyre. Problemet me xhirlogarinë bankare janë zgjedhur dhe, si e tillë, nuk do të përsëritet më gjendja e

mëparshme siç ka qenë për arsye se janë shlyer borxhet ndaj kreditorëve", ka thënë Dugolli. Muaj më parë punëtorët e Pallatit të Rinisë kishin mbajtur grevë dhe protesta në kërkim të pagës së tyre. Punëtorët e kësaj ndërmarrje nuk kishin marrë paga gati për tre muaj rresht.

Mallrat e Serbisë pakësohen dukshëm në tregun e Kosovës



Bujar Tërsteni (RFE/RL)

Janë bërë gati tetë muaj kur Qeveria e Kosovës ka vendosur taksën 100 për qind për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Që nga kjo periudhë importi nga Serbia ka shënuar rënie drastike, thonë autoritetet kompetente në Kosovë

PRISHTINË, 14 KORRIK - Serbia, e cila para vendosjes së taksës ishte eksportuesja më e madhe e produkteve në Kosovë, për këta tetë muajt e fundit ka rënë eksportuese e mallrave në rreth katër milionë euro. Ky shtet, para 21 nëntorit të vitit të kaluar, gjatë një dite ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë prej 1.2 milion eurosh apo më shumë se 360 milionë euro brenda një viti. Adriatik Stavileci, zëdhënës në Doganën e Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se "gjatë ditëve të fundit nuk është vërejtur ndonjë rritje e importit nga Serbia apo rritje e kontrabandës. "Më duhet të theksoj se mallrat nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina nga nëntori i vitit të kaluar kanë shënuar rënie

drastike, kur flitet për importin", ka bërë me dije Stavileci. Mesatarja ditore e importeve nga Serbia, thotë Stavileci, është rreth 10 dërgesa, ku një pjesë prej tyre janë ndihma humanitare, disa janë dërgesa komerciale, të cilat i nënshtrohen taksës prej 100 përqindësh. Produktet komerciale janë ushqime, lëndë e parë, paketim etj. "Vlera e përgjithshme e importeve nga Serbia ka arritur në rreth 4 milionë euro", ka thënë Stavileci. Vetëm në muajin maj, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, importi i mallrave nga Serbia në Kosovë ishte 519 mijë euro, nga më shumë se 39 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Gjatë kësaj periudhe, të aplikimit të taksës, disa shoqata ekonomike dhe organizata joqeveritare kanë bërë hulumtime lidhur me efektet e taksës nga aspekti ekonomik. Disa hulumtime kanë rezultuar se kjo taksë ka ndikuar në rritjen e prodhimeve vendore, përderisa organizata joqeveritare ka pohuar se efektet nuk kanë qenë në nivel të kënaqshëm. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se edhe pas vendosjes së taksës në treg nuk ka pasur mungesë të produkteve, pasi afaristët në Kosovë shumë shpejt kanë gjetur alternativa për zëvendësim të produkteve nga vendet e rajonit dhe Bashkimi

Evropian. "Ne i konsiderojmë dy efekte kryesore, i pari ka të bëjë me riorientimin e tregtisë. Për të gjitha ato produkte me të cilat tregu i Kosovës është furnizuar nga Serbia dhe Bosnja, sot ka zëvendësime nga vendet e tjera. Dhe e dyta, ajo që vërehet është një prani më e madhe e produkteve vendore të konsumit të gjerë", ka theksuar Rukiqi. Po sipas të dhënave të ASK-së, nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, me pjesëmarrje më të lartë të importit në Kosovë janë Gjermania, Greqia dhe Italia, kurse nga vendet e rajonit më produkte me sasi më të mëdha në tregun e Kosovës është Shqipëria e pasuar nga Maqedonia e Veriut. Një efekt tjetër i taksës është edhe luhatja e çmimeve. Berat Rukiqi thotë se gjatë kësaj periudhe ka pasur ngritje të lehtë të çmimeve në disa artikuj. "Sa iu përket çmimeve, normalisht që për disa produkte ka pasur një ngritje të çmimit jo shumë të madhe, sidomos për shkak të koston të transportit. Në çdo rast

furnizimi nga vendet më të largëta ka kosto më madhe të transportit dhe kjo ka ndikuar edhe në çmime", ka shpjeguar Rukiqi. Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar ka marrë vendim për taksën doganore, fillimisht 10 për qind e më pas 100 për qind për produktet e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Përveç efekteve ekonomike kjo taksë ka paraqitur edhe efekte politike. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi kanë kërkuar pezullimin apo anulimin e kësaj takse. Vendosjen e taksës, Beogradi e ka cilësuar si pengesë për vazhdimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Por, autoritetet në Prishtinë kanë deklaruar se taksa 100 për qind ndaj mallrave të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina nuk paraqet pengesë për vazhdimin e dialogut, por pengesa qëndron në mungesën e gatishmërisë së Serbisë për ta njohur Kosovën.

Kosova, më pak grurë



PRISHTINË, 14 KORRIK - Interesimi i bujqve nga Kosova për të mbjellë grurë ka rënë. Sipërfaqet e mbjella me grurë janë përgjysmuar gjatë gjashtë vjetëve të fundit. Gjatë vjeshtës së vitit të kaluar janë mbjellë vetëm 50 mijë hektarë tokë me farë gruri, për dallim nga viti 2012, gjatë të cilit ishin mbjellë 102 hektarë.

Si pasojë, sasia e grurit pritet të mos i përmbushë kërkesat e popullsisë, përkundër se rendi-

menti është i lartë. "Këtë vit rendimenti i grurit është 350 për qind më i mirë sesa në vitin e kaluar. Vitin e kaluar kemi marrë rendimet 1 500 kilogramë dhe nuk ka qenë kualitet, kurse këtë vit presim t'i marrim 6 tonë", ka treguar bujku Shukri Sallahu nga Komuna e Ferizajt, transmeton "Tch".

Ministria e Bujqësisë do të vazhdojë ta subvencionojë grurin me vlerën e njëjtë prej

150 eurosh për hektar, që në total i bie 6.6 milionë euro. Por problemi i vetëm për bujqit nuk mbetet vlera e subvencionimit. Ata thonë se rreziku më i madh është nga importi, pasi çdo vit nga vendet e rajonit vjen sasi e madhe e grurit, çmimi i të cilit është nën vlerën e tregut. "Prej importit rrezikohemi shumë, pasi prej tij mund të vijë grurë prej lloj-lloj klase, mundet me ardhë grurë më i dobët dhe çmimi do të jetë më i

lirë. Pastaj tregu te ne bazohet prej çmimit të importit pa folur për realitetin e klasës së grurit. Importi gjithëherë na dëmton", është shprehur Shukri Sallahu. Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se Serbia ka qenë eksportuesja më e madhe e grurit në Kosovë deri në vendosjen e masës mbrojtëse 100 për qind, për t'u zëvendësuar me grurin që vjen nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Hungaria, Kroacia e Bullgaria.

Në Prizren, Suharekë dhe Rahovec fushata e korrjeshirjeve tashmë ka filluar.

Mbi 1 400 autokombajna do të jenë aktive gjatë fushatës së korrje-shirjeve.

Në gjithë territorin e Kosovës sivjet me kulturën e grurit janë mbjellë 50 mijë hektarë, ndërsa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) i mbështet kultivuesit e grurit dhe farës së grurit përmes pagesave të drejtpërdrejta.

Delegacioni i BQK-së takon zëvendës drejtorin e FMN-së në Samitin e Dubrovnikut

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Një delegacion i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i udhëhequr nga guvernatori i kësaj banke, Fehmi Mehmeti, po merr pjesë në konferencën e organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Qendrore e Kroacisë me temë "Demografia, punësimi dhe rritja: në drejtim të së ardhmes së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore", e cila është duke u mbajtur në Dubrovnik të Kroacisë.

Pjesë e këtij delegacioni është edhe ministri i Financave, Bedri Hamza.

Gjatë kësaj konference delegacioni i BQK-së, i udhëhequr nga guvernatori Mehmeti, ka

zhvilluar takim me zëvendës drejtorin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, të cilin e ka informuar mbi zhvillimet e përgjithshme në sistemin financiar si dhe e ka falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme që FMN-ja i ka ofruar BQK-së ndër vite.

Në këtë takim guvernatori Mehmeti ka shfrytëzuar rastin për ta falënderuar Zhangun për aprovimin e misionit të Shqyrtimit të Stabilitetit të Sistemit Financiar (Financial System Stability Review-FSSR), i cili shqyrtim ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm për BQK-në për diagnostifikimin e gjendjes së sistemit financiar të Republikës së Kosovës.



Ndërsa gjatë konferencës guvernatori Mehmeti ka prezantuar pikëpamjet e Kosovës lidhur me faktorët demografikë dhe ndikimin e

tyre në tregun e punës si në Kosovë, po ashtu edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka tërhequr vëmend-

jen te nevoja e orientimit të fokusit jo vetëm në aspektet pozitive, por në nevojën për hulumtime më të detajuara për t'i kuptuar drejt edhe efektet negative të emigracionit për vendet tona.

Po ashtu, Mehmeti ka theksuar nevojën e adresimit të kësaj çështje me një qasje shumëdimensionale për Ballkanin Perëndimor, në veçanti përmirësimin e cilësisë së qeverisjes, fuqizimin e institucioneve dhe politikave ekonomike për të krijuar një ambient që inkurajon jo vetëm qëndrimin, por edhe kthimin e diasporës në vendet tona, përfshirë kapitalin për investimin në vendet e origjinës.

Mbyllen dy qendra masazhi në Ferizaj

FERIZAJ, 14 KORRIK (ER) - Inspektorati i Komunës së Ferizajt, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, gjeçësisht Njësitin për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në këtë komunë, pas një pune hetimore ka mbyllur dy qendra

masazhi, me dyshimin e bazuar për mundësimin e zhvillimit të prostitucionit, me ç'rast janë arrestuar tre persona.

Ky aksion i përbashkët i forcave të rendit dhe inspektoratit të komunës ka ardhur si rrjedhojë

e vëzhgimeve nga afër të këtyre lokaleve nga organet e rendit, me dyshimin se po zhvillohej veprimtari e paligjshme. Lokalet e mbyllura gjendeshin në zonën prapa Gjimnazit të Shkencave Shoqërore "Dr. Shaban Hashani" dhe në

rrugën "Kemajl Hetemi.

Të arrestuarit, me vendim të prokurorit, janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

Ridvan Berisha, kryeinspektor i inspektoratit të Ferizajt, ka thënë se bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe vigjilen-



ca e inspektorëve komunalë po jep rezultate domethënëse për jetën, sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve.

Komuna e Gjilanit në përmbyllje të asfaltimit të rrugëve në lagjen 'Arbëria'



GJILAN, 14 KORRIK (ER) - Komuna e Gjilanit në kuadër të angazhimeve të përditshme për investime në infrastrukturë publike, ujësjellës, kanalizim, trotuare, gjelbërim, ndriçim publik, ka përfunduar asfaltimin e disa rrugëve në lagjen "Arbëria", saktësisht rrugët "Hysen Tërpeza" dhe do të asfaltohen të gjitha të tjerat për ta përmbyllur plotësisht nevojën e kësaj lagjeje për asfaltim. Drejtori i Shërbimeve Publike të Infrastrukturës dhe Banimit, Naser Korça, ka thënë se janë të kontraktuara të gjitha rrugët në lagjen "Arbëria" dhe procesi i asfaltimeve do të përfundojë brenda një muaji. "Deri më tani janë asfaltuar më shumë se gjysma e tyre dhe brenda një

muaji do të kryhen të gjitha. Në këtë fazë kemi përmbyllur asfaltimin e rrugëve 'Hysen Tërpeza'. Me dinamikë maksimale po punojmë që ta shfrytëzojmë periudhën sa është koha e mirë për t'i asfaltuar rrugët që i kemi të parapara me buxhetin e komunës dhe ato që janë në bashkëfinancim me qeverinë për Komunën e Gjilanit", ka thënë drejtori Korça.

Ai ka konfirmuar se me mbështetjen e vazhdueshme të kryetarit Lutfi Haziri do të punojnë në të gjitha lagjet, ku janë iniciuar procedurat e prokurimit dhe do të vazhdojnë edhe procedimin e të gjitha rrugëve të cilat janë planifikuar në programin për investimet kapitale për vitin 2019.

Rregullohet ndriçimi edhe në tre fshatra të Malishevës

MALISHEVË, 14 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës është duke e realizuar një prej projekteve më të kërkuara nga ana e banorëve, atë të rregullimit të ndriçimit publik nëpër vendbanimet e saj.

Në kuadër të realizimit të këtij projekti ka përfunduar rregullimi i ndriçimit edhe në tre fshatra: në Bubavec, Mleqan dhe në pjesën më të madhe të Turjakës. Rregullimin e ndriçimit në këta fshatra e kanë inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori i Inspektoratit, Dibran Kastrati, të cilët janë

ndarë të kënaqur me realizimin e deritanishëm të këtij projekti. Po ashtu, Berisha dhe Kastrati janë takuar edhe me banorët të cilët gjatë inspektimit ishin duke ecur rrugëve tashmë të ndriçuara. "Realizimi i projektit është duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë dhe janë duke u zbatuar kriteret e projektit. Edhe banorët e këtyre vendbanimeve janë të kënaqur me rregullimin e ndriçimit, pasi kjo u mundëson lëvizje të lirë por, mbi të gjitha, u krijon siguri", ka thënë nënkryetari Berisha gjatë vizitës në Turjakë dhe Bubavec.



Skenderaj mban dy muaj aktivitete për diasporën

SKENDERAJ, 14 KORRIK (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nga sot (e hënë) do të fillojnë aktivitetet argëtuese dhe kulturore për nder të bashkatdhetarëve të cilët ndodhen për pushime në vendin e tyre të lindjes. Kjo komunë ka bërë me dije se gjatë dy muajve do të organizohen edhe panaire të veshjes sonë tradicionale,

muzikë në Sheshin "Adem Jashari", por edhe aktivitete të tjera të larmishme në mënyrë që bashkatdhetarët dhe qytetarët të argëtohen gjatë muajve të verës.

Sipas njoftimit të Komunës së Skenderajt, kryetari Jashari u ka uruar mirëseardhje të gjithë bashkatdhetarëve të cilët janë në vendlindje për pushime. "Për ta ruajtur traditën e zemërgjerë-

sisë së drenicasve, edhe sivjet vazhdon Sofra e Drenicës me këngë e valle, humor e poezi, rreth së cilës presim me dashamirësi bashkatdhetarët tanë. Nga e hëna përgjatë dy muajve në vazhdim, Sheshi 'Adem Jashari' do të gjallërojë nga aktivitetet e organizuara, në nderim dhe mirëseardhjeje për motrat dhe vëllezërit tanë nga diaspora", ka thënë Jashari.

'Ballkani - diplomacia e munguar'

Lisen Bashkurti

BALLKANI - Diplomacia e Munguar

Artikuj, Intervista, Aforizma, Studime

East Print

"...Ballkani ka nevojë për europeanizim në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale. Europeanizim do të thotë paqja t'i mënjanohet luftërat, stabiliteti t'i shmangë krizat, demokracia t'i dominojë regjimet, prosperiteti t'i lumturojë qytetarët. Për këtë Ballkanit i nevojitet më shumë se kurrë diplomacia. Diplomacia si kulturë qytetare, si vlerë shoqërore, si mendim, sjellje dhe qëndrim politik, si zgjidhje institucionale dhe si marrëdhënie ndërkombëtare"

Shtëpia botuese "FAST PRINT"

Këto ditë doli nga shtypi libri më i ri i autorit Lisen Bashkurti, 'Ballkani - diplomacia e munguar', botuar nga Akademia Diplomatike Shqiptare dhe Shtëpia Botuese "Fast Print". Libri është i njëzetetreti në serinë e librave monografikë shkencorë për historinë e diplomacisë, teoritë e politikës dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, çështjet evropiane dhe ballkanike, të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, krizat ndërkombëtare, negociatat diplomatike, diplomacinë publike dhe çështje ndërkombëtare bashkëkohore.

'Ballkani - diplomacia e munguar' ka në përmbajtjen e tij artikuj bashkëkohorë, intervista, aforizma dhe dy studime akademike të fushës. Libri ka në fokus Ballkanin, historinë, tranzicionin dhe ardhmërinë e tij në kontekstin evropian, euro-atlantik dhe global. Gjithçka është parë e trajtuar në perspektivën e marrëdhëniet ndërkombëtare dhe veprimtarisë diplomatike. Pyetja kërkimore që vihet në qendër të librit është definuar qysh në titullin e librit. Ballkani, ky rajon me histori të përgjakshme konfliktesh, krizash

dhe luftërash, i epituar ndërkombëtarisht si 'Fuqi baroti', është dominuar nga nacionalizmi, nga diktaturat, nga militarizmi dhe politikat e dhunshme. Ballkanit, këtij mjedisi historik dhe politik, i kanë munguar qysh në krye të herës humaniteti, iluminizmi, moderniteti, demokracia, e drejta ndërkombëtare dhe diplomacia. Këto vlera të munguara kanë krijuar mure ksenofobie ndërmjet popujve të Ballkanit.

Në kohët tona sfida më e madhe e Ballkanit është të shembë muret e ksenofobisë, frikës, urrejtjes dhe armiqësisë dhe të krijojë një mjedis human, të iluminuar, demokratik, komunikativ, ku të dominojnë bisedimet, dialogu dhe negociatat si rrugët e vetme më të mira, më të lira, më eficientë, më të zbatueshme dhe më afatgjata.

Ballkani ka shumë histori, por pamjaftueshmërisht ka nxjerrë mësimë prej saj. Kujtesa Ballkanike duket akoma dritëshkurtër. Shkolla e historisë në Ballkan nuk ka dhënë shumë mësimë për të mos u përsëritur. Memoria Ballkanike është ende e dominuar nga politizimi i historisë. Ndërsa e sotmja Ballkanike vuan nga historizmi i politikës. Në Ballkan historia dhe politika i përzihen me njëra-tjetrën, duke manipuluar të vërtetat historike të së shkuarës dhe duke mbajtur

peng zhvillimet politike të së sotmes.

Historia Ballkanike sjell më shumë drithë seç mund të bluaj mulliri i këtij Rajoni. Politika Ballkanike ka më shumë oreks për të ngrënë sesa dhëmbë për të bluar ushqimin. Në Ballkan, e kaluara mban peng të sotmen. E sotmja mban peng të ardhmen. Në Ballkan historia dhe politika krijojnë një paradigmë. Kjo paradigmë kryqëzon diplomacinë. Kryqëzimi krijon boshllëk diplomatik. Kur diplomacia mungon, paqja, stabiliteti, demokracia dhe prosperiteti janë në rrezik. Ballkani vijon të mbetet në rrezik, sepse diplomacia e tij është ende e kryqëzuar nga historia dhe politika.

Diplomacia e munguar në Ballkan është kërcënim për paqen, stabilitetin, demokracinë dhe prosperitetin. E thënë ndryshe Ballkani ka nevojë për Europeanizim në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale. Europeanizim do të thotë paqja të mënjanohet luftërat, stabiliteti të shmangë krizat, demokracia të dominojë regjimet, prosperiteti të lumturojë qytetarët. Për këtë Ballkanit i nevojitet më shumë se kurrë diplomacia. Diplomacia si kulturë qytetare, si vlerë shoqërore, si mendim, sjellje dhe qëndrim politik, si zgjidhje institucionale dhe si marrëdhënie ndërkombëtare.

Libri 'Ballkani - diplomacia e munguar' është ndërtuar në tre pjesë: Pjesa e Parë përmban artikuj dhe intervista mbi historinë dhe marrëdhëniet aktuale të Shqipërisë dhe Shqiptarëve me Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe më gjerë. Në mënyrë të veçantë tërheqin vëmendjen bisedimet Kosovë-Serbi dhe skenari për ndarjen e Kosovës nën 'arsyetimin' kontravers të shkëmbimit territorial; dilema e demarkacionit të kufirit Kosovë-Mali i Zi; negociatat Shqipëri-Greqi për delimitimin e kufirit detar dhe marrëveshje të tjera; kriza dhe zgjidhja Greqi-

Maqedoni dhe impakti i saj në Rajon; dinamikat gjeopolitike mbi Ballkan nga hapësira Euro-Atlantike dhe fuqi të tjera globale dhe rajonale jashtë saj; sfidat e integritit të Ballkanit në BE dhe NATO, problemet e diplomacisë në Shqipëri e Kosovë etj.

Në pjesën e dytë, libri përmban një zhanër mjaft të rrallë për botimet tona: aforizma. Bazuar në dituritë teorike, në përvojën personale si dhe në stilistikën e zhanrit të aforizmave në letërsinë botërore, në libër janë dhënë rreth njëqind aforizma të autorit, të lidhura më së shumti me politikën, strategjinë, median dhe diplomacinë. Aforizmat e autorit të këtij libri përbëjnë një nga risitë unike në botimet tona, ku mendimi filozofik dhe shkrimi akademik shprehet me një stilistikë artistike dhe publicistike.

Në pjesën e tretë, libri përmban dy

studime akademike të autorit, një për 100-vjetorin e Luftës së Parë Botërore dhe mësimet që rrjedhin prej saj për mbarë njerëzimin e posaçërisht për Ballkanin nga ku kjo luftë filloi, dhe një studim tjetër për albanofobinë të fqinjët, si sfidë diplomatike e shqiptarëve në rajon.

'Ballkani - diplomacia e munguar', e autorit Lisen Bashkurti vjen në një kohë kur Ballkani përjeton një tranzicion kompleks dhe të vështirë brenda çdo shteti, në marrëdhëniet rajonale, në proceset e integritit evropian dhe euro-atlantik sikundër po përballlet edhe me tendenca pranish dhe ndikimesh gjeopolitike të fuqive të tjera globale dhe rajonale me interesa të ndryshme dhe të kundërta me europeanizmin dhe euro-atlantizmin.



Drejt finalizimit shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari

DRENAS, 14 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se pas finalizimit të shtatoreve të bacës Shaban dhe Hamzës, edhe shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari ka hyrë në procedurën e realizimit të shtatores në argilë, për të vijuar pastaj në bronz. "Tri shtatoret nga nëntori në Sheshin 'Fehmi Lladrovci' në Drenas, përjetësisht do t'i japin vlerë, bukuri dhe mesazh gjeneratave se sa e vlefshme dhe sa e çmueshme është liria", ka thënë kryetari Lladrovci pas vizitës që i ka bërë vendit ku është duke u punuar shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari.

E rrallë

Muzikanti i verbër luan në pianon e përfshirë nga zjarri

Një muzikant rus, i verbër, është filmuar duke interpretuar me piano buzë detit dhe mes zjarrit. Videoja është bërë virale në rrjetet sociale. Videoja muzikore, e cila u ngarkua në "YouTube", tregon Danila Bolshakov, një interpretues nga Shën



Petersburg, duke luajtur "H in New England" të Max Richterit në një plazh në Finlandë.

FOTO E DITES



Banorët e fshatit Huoi Ha, në krahinën e Dien Bien në Vietnam, jetojnë në varfëri ekstreme. Ata fëmijët i fusin në qese plastike për ta kaluar lumin për të shkuar në shkollë.

E jashtëzakonshme

Nga i pastrehë bëhet milioner duke ndërtuar 'plazhe' në banesa

Në moshën 15-vjeçare Eric White do të mbeshte në rrugë për të paktën tetë muaj duke u konsideruar i pastrehë. Ai ndërpreu shkollën, madje kishte vështirësi ta gërmëzonte emrin e vet. "Atij i duhej një mrekulli për të filluar punë", shkruan "Usa Today". Pas disa përpjekjesh, Eric arriti të punësohej në një kompani ndërtimi, pagesa në të cilën i dha mundësi që t'i paguante faturat e



shtëpisë. Me kalimin e viteve, rritjen e pagës dhe ambicien që nuk i mungonte, Eric mendoi të kalonte në një tjetër etapë, ta krijonte kompaninë e tij. Idenë e kishte të qartë, të ndërtonte 'plazhe' në shtëpitë e njerëzve.

BARSOLETA E DITËS



Sa herë që shkoj në restorant e lexoj menynë sikurse lexojnë arabët, prej anës së djathtë në të majtë. Fillimisht çmimin, pastaj ushqimin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min


Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg

Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00
"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Doni pak qetësi sot dhe nëse nuk mund

ta shijoni ditën siç ëndërroni, ta paktën bëni të mundur që të mos keni debate dhe keqkuptime.



DEMI

Nëse merreni kaq shumë

kohë me punën, nuk do të mund t'i dedikoni kohë jetës personale. Duhet t'i ndani prioritetet tuaja të tashme.



BINJAKËT

Edhe pse nuk keni marrë gjithçka që

keni pretenduar, sot bëni mirë të lini pak kohë të kalojë përpara se të kërkonti shpjegime.



GAFORRJA

Keni pak vështirësi ta menaxhoni

kohën për impenjimet tuaja sot. Nëse nuk ia arrini dot i vetëm, kërkonti ndihmë nga kolegët.



LUANI

Nuk është se ju kanë mbetur

shumë gjëra për t'i vlerësuar kohët e fundit. Të gjitha situatat që mund t'i shfrytëzonit i keni mbaruar.



IRGJËRESHA

Disa kritika konstruktive është

mirë kur bëhen në kohë sepse mund të recuperoheni. E rëndësishme është të mos i keqinterpretoni.



PESHORJA

Keni hapur mundësi të reja

bashkëpunimi me persona që i njihni mirë. Nuk jeni penduar aspak për shanset e reja që ju keni dhënë.



AKREPI

Edhe pse biseda me një mik të

vjetër ju bën të mendoni qartë për situatat tuaja, sot nuk do të keni mundësi të konsumoni kohë me të.



SHIGJETARI

Dikush do të jetë pjesë e projekteve

dhe planeve tuaja në të ardhmen. Nuk keni pse e ndaloni sepse ju mund t'ju japë shumë komoditet kjo gjë.



BRICJAPI

Sot nuk keni pse viheni në garë me

të tjerët për t'i treguar aftësitë tuaja. Nëse jeni i bindur që dini t'i bëni mirë gjërat, nuk ka pse tregoni dyshime.



UJORI

Nëse doni ta ngjyrosni ditën tuaj

me sa më shumë humor atëherë duhet të bëni diçka si për ju dhe për personat që doni.



PESHQIT

Sot do të keni bashkëpunime të

frytshme në fushën profesionale dhe mund të vijoni të mbështeteni tek të njëjtët persona.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Sermaxhaj: Feronikeli do ta bëjë historinë në Ligën e Kampionëve

Njohësi i lojës së futbollit dhe ish-reprezentuesi i Kosovës, Genc Sermaxhaj, është optimist se Feronikeli ka kualitet të mjaftueshëm për ta eliminuar The New Saintsin dhe në këtë mënyrë ta shkruajë historinë në Ligën e Kampionëve, duke u bërë skuadra e parë nga Kosova që arrin me së largu në këtë garë. "Besoj se Feronikeli e kalon këtë raund dhe do të bëhet ekipi i parë nga Kosova që ka kaluar më së shumti raunde në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve", ka thënë Sermaxhaj



jenë në stadium. Këto bileta shpërndahen të martën nga ora 09:00 - 12:00 në pikat shitëse të lartcekura dhe do të jepet vetëm një biletë për person. Ndërsa çmimi i biletave për zonën veri dhe jug është 3 euro, në lindje biletat kushtojnë 5 euro, ndërsa në perëndim 10 euro. Ndërsa për zonën VIP biletat kushtojnë 15 euro.

'NIKLI' NDERON INVALIDËT

Risi në ndeshjen që zhvillohet të martën është se invalidët e luftës çlirimtare do ta kenë hyrjen pa pagesë për ta përcjellë nga afër ndeshjen më të rëndësishme në histori të Feronikelit. "Përveç 3 000 biletave falas që do të jenë në dispozicion, klubi i Feronikelit ka marrë vendim që hyrje falas të ketë edhe për invalidët e luftës. Të gjithë invalidët që shfaqen me kartela te pikat hyrëse para ndeshjes do ta kenë hyrjen falas në stadiumin 'Fadil Vokrri'.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Skuadra kampione e Kosovës, Feronikeli, e pret skuadrën nga Uellsit, The New Saints, për ta zhvilluar ndeshjen e kthimit të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Trajneri dhe analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, të dielën për "Epokën e re" ka thënë se Feronikeli i ka shanset e mira për

ta shkruar historinë si skuadra e parë nga Kosova që arrin me së largu në garën e Ligës së Kampionëve. Ish-lojtari i shumë skuadrave në Kosovë beson se rezultati 2-2 e favorizon skuadrën e Kosovës për të kaluar në rrethin e dytë në garën më të fortë në futboll. "Mundësitë e Feronikelit janë shumë të mira për kualifikim tutje, sidomos me rezultatin 2-2 ndaj ekipit më të mirë uellsian. Paraqitja dhe rezultati i Feronikelit në ndeshjen e parë ka

qenë mbresëlënëse dhe tash shanset e 'Niklit' për të ecur tutje janë rritur, por duhet shumë koncentrim, angazhim dhe gjithë energjinë duhet të shpenzohen në mënyrë racionale. Rezultati i ndeshjes së kaluar është përparësi për skuadrën tonë dhe na konvenojmë edhe dy rezultate të barabarta (0-0, 1-1), por duke e pasur parasysh se jemi mirë në aspektin psikik, pres të kalojmë pozitivisht. Besoj se Feronikeli e kalon këtë raund dhe do të bëhet

ekipi i parë nga Kosova që ka kaluar më së shumti raunde në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve", ka thënë Sermaxhaj. Ndeshja në mes të Feronikelit dhe The New Saintsit po pritet me interesim të madh, kurse klubi nga Drenasi ka njoftuar se të hënën dalin në shitje biletat nga ora 10:00-18:00. Presidenti i Feronikelit, Naser Ramaj, ka vendosur t'i dhurojë 3 000 bileta falas për të gjithë ata që duan të

Loriana mbetet pa medalje, Akili i artë në Hungari

BUDAPEST, 14 KORRIK - Loriana Kuka nuk ka mundur ta ndjekë rrugën e Akil Gjakovës, Nora Gjakovës dhe Distria Krasniqit, të cilët fituan medalje në Grand Prixin e Xhudos në Budapest të Hungarisë. Loriana shënoi një fitore dhe dy humbje, derisa zuri vendin e shtatë. Me këtë pozitë ajo shton në konton e saj edhe fiton 182 pikë olimpikë, për ta ndjekur suksesshëm normën olimpikë "Tokio 2020". Loriana muajin e kaluar fitoi medaljen e bronzit në Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Mirëpo të shtunën Akil Gjakova e fitoi medaljen e artë në kat-



egorinë - 73 kilogramë. Akili mposhti me Ippon rusin Gjeorgii Elbakiev. Në përgjithësi, Gjakova fitoi pesë luftëra dhe fitoi 700 pikë olimpikë për "Tokio 2020". Ndërkohë, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi kanë fituar medaljet e argjendta.

Prishtina sot 'ndez' motorët për edicionin e ri

PRISHTINË, 14 KORRIK - FC Prishtina, pas një pushimi dhjetëditorë, sot (hënë) fillon përgatitjet për edicionin e ri futbollistik 2019/2020. Kryeqytetasit e Kosovës e mbyllën një edicion pa trofe, pasi humbën garën me Feronikelin për titull dhe Kupë, kurse janë eliminuar herët nga Liga e Evropës. "Prishtina të hënën nis fazën përgatitore për edicionin e ri të kampionatit 2019/20. Skuadra nuk do të jetë tërësisht e kompletuar deri të martën apo të mërkurën kur disa nga futbollistët kthehen nga pushimi jashtë vendit", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Në skuadrën "bardhekaltrë" do të provohen tre futbollistë, në mesin e tyre një brazilian, një jugkorean dhe shqiptari nga Kroacia, ish-anëtari i kategorive të reja të Osijekut, Adem Jahaj. Ndërsa si futbollist i ri i skuadrës do të prezantohet ish-futbollist i deritanishëm i Vëllaznimit, anëtari i



grupmoshave të reja të Përfaqësueses së Kosovës, Arti Maloku. FC Prishtina të dielën ka njoftuar edhe ndarjen me mbrojtësin e majtë, Abdul Bashiru dhe mesfushorin Donat Hasanaj. Prishtina njoftoi se marrëveshja ka qenë e dyanshme për ndërprerjen e kontratës me 27-vjeçarin nga Gana. Ndërsa 20-vjeçari Hasanaj që ka dalë nga Shkolla e Futbollit të Prishtinës, karrierën do ta vazhdojë në skuadrën e Dritës nga Gjilani.

Hamiltoni, rekord historik në Silverstone, zhgënjën Vetteli

NORTHAMPTON, 14 KORRIK - Lewis Hamiltoni është fituesi i Çmimit të Madh të Anglisë, duke triumfuar sërish në pistën e Silverstones dhe vendosi rekord si piloti me më

shumë tore në garën e shtëpisë (10 tore). Pavarësisht se e nisi në "pole position", Valteri Bottas e mbylli në vend të dytë, duke kompletuar për herë të shtatë një podium dysh

për Mercedesin. Ndërkohë që për Ferrarin e vetmja gjë pozitive janë paraqitjet e Charles Leclerc, i cili u ngjiti në shkallën e tretë të podiumit. Sebastian Vetteli, i nisur nga

vendi i gjashtë, katranosi gjithçka në gjiron e 37, kur në tentativë për të kaluar Max Verstappen e goditi nga pas, duke dëmtuar hundën e makinës dhe mori 10 sekonda

penallti, duke u renditur në vend të 16. Gara e ardhshme është më 28 korrik, pas dy javësh, për Çmimin e Madh të Gjermanisë në pistën e Hockenheimringut.

Vëllaznimi prezanton Pajazitin

GJAKOVË, 14 KORRIK - Skuadra e Vëllaznimit e ka prezantuar trajnerin e ri Sadat Pajaziti. Ish-trajneri i KEK-ut, Drenicës, Dritës dhe Gjilanit do t'i prijë skuadrës gjakovare në edicionin

2019/2020 me synim për t'u inkuadruar në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Klubi i Futbollit Vëllaznimi arriti marrëveshje bashkëpunimi për një vit me trajner-

in e njohur Sadat Pajaziti. Kështu, Pajaziti do t'i prijë skuadrës në edicionin e garave 2019-2020", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi nga Gjakova.



IHF-ja: Kosova shkruan historinë në Spanjë

PRISHTINË, 14 KORRIK - Federata Ndërkombëtare e Hendbollit ia ka kushtuar një artikull pjesëmarrjes së Kosovës në Kampionatin Botëror të juniorëve në Spanjë. Përfaqësuesja e U21 në hendboll është e para përfaqësuese e Kosovës në të gjitha sportet dhe në të gjitha grupmoshat që është kualifikuar për kampionat botëror. U21-shat "Dardanë" janë po ashtu ekipi i parë i kualifikuar për botëror përmes garës IHF Trophy dhe e ka arritur këtë duke fituar fazën interkontinentale të mbajtur në Prishtinë në prill. Për trajnerin Fatmir Muhaxheri suksesi në IHF Trophy ishte kulmi i punës shumëvjeçare. "Ne e kemi merituar atë sukses, pasi kemi stërvitur për katër vjet, jemi munduar për katër vjet dhe e meritojmë të jemi pjesë e kampionatit botëror", i ka thënë Muhaxheri faqes zyrtare të IHF-së, pasi Kosova fitoi titullin. "Tani do të punojmë shumë që të paraqitemi sa më mirë në Spanjë". Ekipi i tij u kualifikua për fazën interkontinentale pasi fitoi zonën evropiane të IHF Trophy. Me valën e suksesit që ka përfshirë hendbollin kosovar së fundi - ekipi senior i Kosovës së fundi ka fituar ndaj Izraelit - presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, është i vetëdijshëm për rëndësinë e organizimit të ngjarjeve ndërkombëtare dhe paraqitjes në to. "Hendblli në Kosovë është themeluar 65 vjet më parë, por për ne është me shumë rëndësi të kemi impakt tjetër, dhe një mënyrë për të



bërë këtë është të organizojmë ngjarje ndërkombëtare. Suksesi në fushën e lojës është nxitje për ekipet që të punojnë më shumë dhe të arrijnë rezultate më të mira. Natyrisht, do të ketë sfida në botërorin e juniorëve, por jemi të sigurt që IHF-ja, Federata e Hendbollit e Spanjës dhe komiteti organizativ lokal do të bëjnë punë fantastike. Hendblli në Kosovë është në rritje dhe kjo ngjarje do ta inspirojë gjeneratën e re t'i bashkohet familjes së hendbollit", ka thënë Saraçini. Selektori i Kosovës, Taip Ramadani, që ka prezantuar Australinë në Lojërat Olimpikë të vitit 2000 në Sydney, do të jetë në Spanjë si udhëheqës i delegacionit dhe, krahas Muhaxherit, do të shpresojë që do të mund ta inspirojë ekipin e ri që të shkojë sa më larg që është e mundur. "Presim garë të vështirë. Është botërori i parë për ne dhe është shumë me rëndësi për vendin tonë të ri, pasi është, po ashtu, hera e parë që një ekip sportiv do ta prezantojë vendin tonë në një botëror në të gjitha sportet. Të marrim

pjesë në botëror është krenari për ne dhe qartë se do të motivojë një valë të re fëmijësh që të merren me hendboll, sportin me histori të pasur në vendin tonë. Qëllimi ynë është ta prezantojmë vendin tonë me krenari dhe dinjitet dhe të garojmë për më të mirën. Lojtarët tanë janë të motivuar për të performuar në këtë nivel dhe të jenë pjesë e një ngjarje kaq të madhe. Shpresojmë të dalim në raundin kryesor dhe të vazhdojmë t'i sfidojmë ekipet superiore ndërkombëtare", ka thënë Ramadani. Në përfaqësuesen e Kosovës janë disa lojtarë që bëjnë karrierë në vende të tjera. Drenit Tahirukaj, që luan për Besa Famgas, ishte top golshënuesi në fazën interkontinentale të IHF Trophy, duke shënuar 31 herë në katër ndeshje. "Nuk kam fjalë për ta shpjeguar ndjenjën kur e veshi fanellën e vendit dhe dëgjoi himnin. Ndihej shumë krenar që luaj për vendin tim. Kemi talent dhe me punë të madhe mund të shkojmë larg", ka thënë kapiteni i Kosovës U21, Jon Muqolli.

Serena e ka planin për ta thyer mallkimin e finaleve

LONDËR, 14 KORRIK - Tenistja amerikane Serena Williams humbet për të tretën herë me radhë në finalen e një grand slam-i (Wimbledon 2018, US Open 2018 dhe Wimbledon 2019). Një statistikë aspak e zakonshme për një ikonë të këtij sporti, që në karrierën e saj ka fituar 23 grand slam-e dhe është një tore larg rekordit të Margaret Court. "Nuk e kuptoj se çfarë po më ndodh në këto finale. Ndaj Simona nuk kisha asnjë shans të



strategji, por pa sukses", ka thënë Serena Williams. "Nuk heq dorë, më duhet të gjej një rrugë për të fituar një nale në grand slam. Ndoshta duhet të luaj më shpesh, të marr pjesë edhe në turnetë Masters, të shkoj deri në finale në mënyrë që ta heq këtë ters. Kjo besoj se do të më ndihmojë për t'u zhbllokuar në këto finale", ka thënë Serena, që konfirmoi se do të luajë në turnetë Masters të Torontos dhe Sinsinatit.

SHKURT

Florian Marku regjistron fitoren e katërt si profesionist

Florian Marku ka fituar duelin e tij të katërt si profesionist duke mundur anglezin Tommy Broadbent. Dueli i zhvilluar në "O2 Arena", Londër, përfundoi në raundin e katërt teksa një grusht i Markut në trupin e kundërshtarit i dha fund përballjes. Marku ruan rekordin e pandërprerë të fitoreve me nokaut, ndërsa kjo ishte humbja e parë e Broadbent me nokaut. Anglezi e filloi raundin e parë më mirë, por me fillimin e raundit e dytë Marku mori kontrollin e duelit dhe Broadbent filloi të zbraspsej. Gjatë duelit kishte momente ku boksierët më shumë po fyenin njëri-tjetrin, duke harruar grushtet. Vlen për t'u përmendur mbështetja e komunitetit shqiptar në Angli që krijoi një atmosferë elektrizuese gjatë duelit të 26-vjeçarit.

Ramadani fiton medaljen e artë

Talenti i atletikës, Muhamet Ramadani ka fituar medaljen e artë në Kampionatin Ballkanik U18, që po mbahet në Stamboll të Turqisë. Muhameti fitoi të artën në hedhjen e gjyles. Distanca e hedhjes ishte 19.31 metra. Ramadani do ta përfaqësojë Kosovën edhe në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019".

Griezmanni: Dua të fitoj gjithçka me Barçën

Antoine Griezmann është i vendosur të bëjë një ndikim të madh te Barçelona pas transferimit prej 120 milionë eurosh nga Atletico Madridi. Reprerentuesi francez komplettoi kalimin e tij nga Atletico më 12 korrik dhe është i gatshëm të fillojë menjëherë me klubin nga "Camp Nou". Griezmann ka folur për objektivat e tij me katalunasin, ku ka theksuar se dëshiron t'i fitojë të gjithë trofetë. "Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe jam i entuziazmuar për të filluar. Jam i etur për të filluar dhe për të punuar me grupin. Do të ketë sfida të reja dhe unë dua të fitoj gjithçka - Ligën, Copa del Rey dhe Ligën e Kampionëve" ka thënë Griezmann.

Halep, fituese e Wimbledonit

Tenistja rumune, Simona Halep ka mposhtur amerikanen Serena Williams në finalen e Wimbledonit - duke pamundësuar që Williams të fitojë titullin e 24-të turneve Grand Slam. Halep 27-vjeçare, mposhti Williamsin me rezultat 6-2, 6-2 në sete. Ky është viti i dytë me radhë që Williamsi arrin në finale me shpresën që do ta barazojë rekordin me 24 tituj Grand Slam me tenisten Margaret Court. Vitin e kaluar, Williams u mposht në finale të Wimbledonit nga gjermania Angelique Keber, përpara se të humbte edhe finalen në U.S Open. Ndërkaq, fitorja e sotme në Wimbledon është titulli i dytë më i madh që ka fituar Halep. Ajo më 2018 fitoi turneun French Open. Në kategorinë e meshkujve, në finale më 14 korrik, do të përballen zvicerani Roger Federer dhe serbi Novak Djoković.

Bayerni, 45 milionë sterlina Hudson-Odoi

Chelsea rrezikon ta humbasë sulmuesin e vet të talentuar për asgjë, në janar. Nisur nga kjo situatë, Bayern Munich është i vendosur të hidhet në sulm për Callum Hudson-Odoi, duke bërë një ofertë prej 45 milionë sterlinash, raporton "Daily Mail". Kjo ofertë do të jetë 10 milionë sterlina më shumë se ajo që kampionët e Bundesligës bëjnë të blutë e Londrës për Hudson-Odoi, në janar të këtij viti. Frank Lampard dëshiron ta bindë lojtarin të qëndrojë në "Stamford Bridge", por nëse Chelsea nuk e pranon ofertën bavareze, rrezikon ta humbasë falas sulmuesin e ri, përmes një kontrate paraprahe në janar të vitit të ardhshëm. Kjo për shkak se i skadon kontrata në fund të sezonit të ardhshëm dhe del lojtar i lirë. Ai nuk ka rinovuar ende me londinezët.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në
Shitjen 48

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: e mërkurë **17 korrik 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,
në "Sallën e konferencave - Hotel Grand", Prishtinë.

*** Shënim:** Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja e aseteve 46:

Njësia nr.12: IMB Lokali në Zubin Potok


Njësia nr.15: Univerzal Lokali 5 në Leposaviq

Njësia nr.38: IMB Lokali 8

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një pliko (zarf) të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (**ZARFI 3**), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: **ZARFI 1** dhe **ZARFI 2**



Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit
"Informata shtesë për ofertën"

1. Dokumentet e cekura në pikën 8.6. ii të Rregullave të Tenderit.
2. Originalin e formularit për dorëzimin e ofertës - "SHTOJA C", e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.

SHTOJA "B" - PASQYRA E ÇMIMIT TË OFERTËS

Emri i Plotë i Ofertuesit: *Fila Fiste*
Numri i njësisë dhe emri i aseti/subjekti të ri: *Njësia nr. 12 (emri i njësies)*
SHAL numër: *5491 402*

ÇMIMI I OFERTËS – SHËNO ÇMIMIN E OFERTËS QË JU SYNONI TË PAGUANI PËR SUBRIKTIN RI NË SHIFRA

Dyfishimi	Dyfishimi	Udhëzimi	Dyfishimi	Dyfishimi	Dyfishimi	Dyfishimi	Dyfishimi	Dyfishimi	Dyfishimi
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

NË FIALE: *Njësia nr. 12*

SHËNIME:
- NË RAST TË ÇARËDO MOSPËRPUTHJE NË TABELË, NË MËS TË SHUMËS SË PARAQITUR ME SHKRONIA DHE SHUMËS SË PARAQITUR ME SHIFRA DO TË MBIZOTËROI SHUMA E PARAQITUR NË SHKRONIA DHE DO TË TRAJTOHET SI ÇMIMI I OFERTËS.
- NË RAST SE SHUMA E PARAQITUR ME SHIFRA DHE SHUMA E PARAQITUR ME FIALE JANË TË PALEXUESHME DHE/OSE TË PAKËPTUESHME, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHET.
- NUK LEJOHET ASNJË NDRYSHIM/PËRMIRËSIM I ÇMIMIT TË OFERTËS.
- AGJENCIA DO TË SHPALL TË PAVLESHME OFERTËN E DORËZUAR E CILA KA NDRYSHIM/PËRMIRËSIM TË ÇMIMIT TË OFERTËS SIPAS NENIT 13.1 TË KESAJ RREGULLOREJE.
- NË RAST SE OFERTUESI NUK PARAQET ÇMIMIN E OFERTËS, EDHE ME FIALE EDHE ME SHIFRA, OFERTA E TË DO TË DISKUALIFIKOHET.

Emri & Mbiemri: *Fila Fiste* Data: *XXXXXX*
Nënshkrimi: *F. Fiste*

Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi pranon shënimet më lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu.
Vërejtje: Ju lutem keni parasysh se të gjitha fushat duhet të jenë të plotësuara. Në rast se ndonjëra nga informatat mëtej e plotësuara, oferta do të diskualifikohet.

TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!!
KUJDES,

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 48 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevc Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org



Republika e Kosovë
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetit të Bolniçke i Klinikë Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universiteti i Klinikë Centar Kosova - University
Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212; Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; neni 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, neni 10 dhe neni 13 paragrafi 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); neni 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, neni 13 paragrafi 1 dhe neni 15, paragrafi 3 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; neni 62 paragrafi 6 i Ligjit Nr.04/L-125, dhe kërkesës të Drejtorit të Shërbimit Klinik i Mjekësisë Nukleare me datë 10.06.2019 Qendra Klinike Universitare e Kosovës, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për:	Radiofarmacistit në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare	(1) pozitë
	Fizikant Mjekësorë në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare	(3) Pozita:
1	Fizikant Mjekësorë në Klinikën e Onkologjisë	(1) pozitë
2	Fizikant Mjekësorë në Klinikën e Radiologjisë	(1) pozitë
3	Fizikant Mjekësorë në Mjekësisë Nukleare	(1) pozitë

Institucioni: Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)
Departamenti: Shërbimi klinik i Mjekësisë Nukleare të QKUK-së
Norma e punës: Orari i plotë,
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
I Raportoni: Drejtorit të Shërbimit Klinik i Mjekësisë Nukleare të QKUK-së
Koeficienti: 7.2
Nr. i Refere.: SHSKUK - QKUK -35/2019-07/4

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Fizikant Mjekësorë në Klinikën e Onkologjisë

Fizikant Mjekësorë i angazhuar në Klinikën e Onkologjisë i përgjigjet shefit të Shërbimit të Fizikës Mjekësore dhe Drejtorit të Klinikës ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Realizimin dhe aprovimin (vetëm Eksperti i Fizikës Mjekësore) e planeve për trajtim radio-terapeutik të pacientëve;
- Kryen dozimetria ditore, javore dhe të përgjithshme.
- Merr pjesë në pozicionimin e pacientëve
- Mbikëqyr stafin terapeutik (teknikët) në zbatimin rigoroz të planeve të trajtimit dhe përdorimin korrekt të pajisjeve imobizilizuere;
- Koordinon simulimet për trajtimin dhe lokalizimin e tumoreve me pajisje (aparate) të dhura (përfshirë CT simulator) për trajtim dhe planifikim radio-onkologjik;
- Kryen kalkulimet e dhura të shpërndarjes së dozave të përkrahura mbrenda vëllimit të synuar (target volume);
- Shqyrton strukturat përkufizim dozash (organet në risk), në dizajnimin e planeve të trajtimit;
- Kryen kalibrimin kualitativ (dozimetri absolute dhe relative) dhe sigurimin e cilësisë (QA) të aparateve rreza-tuese (CT simulatorëve dhe përshejtuesve lineare);
- Mbikëqyr, kryen ose ndihmon në zbatimin e metodave specifike të dozimetrisë duke përfshirë përdorimin e dhomës jonizuese, TLD, apo matjen me film sipas udhëzimeve dhe standardeve më të avancuara;
- Merr pjesë në kërkime klinike për zhvillimin dhe implementimin e teknikave të reja;
- Merr pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional në fushën e teknikave aktuale të trajtimit dhe në avancimet e dozimetrisë mjekësore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Fizikant Mjekësorë në Klinikën e Radiologjisë

Fizikant Mjekësorë i angazhuar në Klinikën e Radiologjisë i përgjigjet shefit të Shërbimit të Fizikës Mjekësore dhe Drejtorit të Klinikës ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Specifikimi i performancës së pajisjeve të reja
- Mbikëqyrja e testimit të pajisjeve si dhe verifikimi i performancës së tyre
- Mbikëqyrja e kalibrimit, mirëmbajtjes si dhe riparimit të pajisjeve si dhe përgatitja e dokumentacioneve me të gjitha informatat e nevojshme.
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e programit të menaxhimit të cilësisë për të gjitha pajisjet imazherike me qëllim prodhimin e imazheve me cilësi optimale duke minimizuar dozat e rrezatimit tek pacientët.
- Përgjegjësia për mirëmbajtjen dhe përdorimin e rregullt të të gjitha instrumenteve matëse për kontrollin e cilësisë së imazheve, cilësisë së kontrollit si dhe ekspozimit të pacientit
- Përcaktimi i dozave për procedurat diagnostike
- Sigurimi i përdorimit të teknikës së rregullt nga teknikët e radiologjisë p.sh në aspektin e pozicionimit të saktë, mbrojtja nga rrezatimi etj.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e programit për mbrojtjen nga rrezatimi, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet përgjegjëse si dhe të bashkëpunoj ngushtë me AKMRrSB duke raportuar rregullisht sipas kërkesave të tyre
- Administrimi dhe monitorimi i dozave të absorbuar tek personeli
- Përcaktimi i kushteve për mbrojtje nga rrezatimi për pajisjet e reja apo ato të renovuara, dhomave ku përdoret rrezatimi jonizues si dhe përcaktimi i radiofrekuencave të fushave magnetike.
- Edukimi i stafit për të siguruar përdorimin e saktë të teknologjive të reja
- Informimi i saktë i pacientëve për shqetësimet që kanë në aspektin e ekspozimit ndaj rrezatimit.
- Projektimi dhe zhvillimi i objekteve të reja ku planifikohet të punohet me rrezatime jonizuese, në aspektin e mbrojtjes nga rrezatimi.
- Informimin dhe trajnimin e studentëve gjatë praktikës profesionale në aspektin e fizikës dhe mbrojtjen nga rrezatimi.
- Edukimi i vazhdueshëm i sigurisë për të gjithë të punësuarit në institucionin i cili është i ekspozuar rrezatimit jonizues ose punon në afërsitë dhomave ku shfrytëzohet rrezatimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Fizikant Mjekësorë në Mjekësisë Nukleare

Fizikant Mjekësorë i angazhuar në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare i përgjigjet shefit të Shërbimit të Fizikës Mjekësore dhe Drejtorit të Shërbimit të Mjekësisë Nukleare ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Këshillimi i pacientëve që i nënshtrohen radionuklidëve dhe familjarëve të tyre që ekspozimi i tyre ndaj rrezatimit të jetë minimal
- Minimizimi i dozës ndaj organeve të riskut
- Mbajtja e shënimeve të radionuklidëve të përdorura dhe monitorimi i sigurisë së tyre
- Administrimi i autorizimeve-licencave për përdorimin e radionuklidëve brenda departamentit të mjekësisë Nukleare.
- Në raste të aksidenteve-kontaminimit me materiale radioaktive, kryerja e të gjitha matjeve dhe vlerësimeve mbi nivelin e sigurisë, si dhe dekontaminimin e personave ose vendit të kontaminuar
- Testimi dhe përdorimi i rregullt i pajisjeve mbrojtëse si dhe instrumenteve monitoruese të rrezatimit si dhe mbikëqyrjen e duhur të dozimetrisë personale të stafit.

- Të llogaris dozat që jepen për ekzaminim ose terapi duke u nisur nga zvogëlimi në minimum i efekteve dëmtoese të rrezatimit.
- Kontrolli i rregullt i cilësisë së kalibratorëve të dozës
- Të hartoj protokollet e matjes dhe llogaritjes së ekzaminimeve in vitro duke zgjedhur kurbat më të përshtatshme të përafërimit si dhe ti kryej ato
- Të menaxhoj, monitoroj, materialin dhe mbeturinat radioaktive si dhe të kontrolloj pastërtinë e materialit radioaktiv që vjen nga importi. Po ashtu të bashkëpunoj ngushtë me AKMRrSB dhe të raportoj sipas kërkesës së tyre (Sipas Nevojave) në rast të incidentit të rrezatimit të raportoj tek autoritetet rregullatorë që përfshijnë atë që ka ndodhur, vlerësimet e ekspozimit të rrezatimit ndaj individëve, veprimet e ndërmarrja dhe rekomandimet se si të parandalohen përsëritjet.
- Të hartoj planin për shfrytëzimin maksimal të lëndëve radioaktive sipas aktiviteteve që kërkon çdo ekzaminim si dhe zgjedhjen e atyre metodave që eliminojnë matjet shumëfish.
- Të kalibroj aparatun për specifikën e ekzaminimit që do të kryhet si dhe të zgjedh kolimatorët e përshtatshëm për izotopin që përdoret dhe organin që ekspozohet si dhe kushtet teknike të realizimit të saj
- Të bëj përpunimin statistikor të rezultateve dhe të gjej gabimin e mundshëm në matje duke bërë korigjimet përkatëse
- Verifikon vërtetësinë e pragut të sistemeve të sinjalizimeve (të alarmit) dhe të saktësisë së matjeve të radioaktivitetit.
- Trajnon dhe kualifikon sipas një programi të miratuar nga Drejtori i Shërbimit Klinik të Mjekësisë Nukleare, kuadrin e mesëm.

Kushtet për Fizikanët Mjekësor:

- Të ketë të mbaruar: studimet themelore në drejtimin e Fizikës Inxhinierike, Master në Fizikë Mjekësore apo Fizikë.
- Të ketë përvojë pune së paku një vit në Institucione shëndetësore ku punohet me burime të rrezatimit jonizues.
- Të njoh punën për mbrojtje nga rrezatimi
- Të ketë specializimin në Fizikë Mjekësore rrespektivisht njohjen Ekspert i Fizikës Mjekësore (përparësi)
- E preferuar që kandidatët të kenë Studime Postdiplomike/Doktoratur, Punime shkencore në lëmin e Fizikës.
- Njohja e punës me kompjuter (word, Excel) ndërkaj për Fizikanin në Onkologji (XtO, Focal, Mozaik)
- Njohja e Gjuhës Angleze
 - Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
 - Certifikaten e lindjes,
 - Leternjoftimi, kopje.

Detyrat e Radiofarmacistit në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare

Radiofarmacisti i Shërbimit Klinik të Mjekësisë Nukleare i përgjigjet Drejtorit të Shërbimit dhe ka për detyrë:

- Të kontrollojë cilësinë e reagentëve joradioaktivë të ekzaminimeve in vitro dhe in vivo, aftësinë lidhëse të tyre.
- Të kryejë të gjithë procedurat kimike për ekstraktimin e hormoneve ose substancave të tjera deri tek fillimi i procedurave së radioimunose nga ana e Laboratorit – RIA në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare.
- Të pranohet me menaxhoj me radiofarmaket nga prodhuesit: cilësinë e produktit, kushtet e farmakopese.
- Përgaditë dhe jep radiofarmakët që përdoren te pacientët për diagnostikim apo për terapi.
- Aplikon principet dhe praktikën farmaceutike dhe të radiokimisë.
- Pranon përshkrimin nga mjeku dhe e rishikon përshkrimin e dhënë nëse është i përshtatshëm apo jo radiofarmaku i përkatës për përdorim
- Verifikon se një substancë radioaktive dhe reagenti do të japin rezultatin e dëshiruar.
- Egzaminon procedurat e trajtimit dhe edukon stafin rreth preparateve radiofarmaceutike.
- Kalkulon vëllimin e preparateve radioaktive që ju jepen pacientëve
- Kombinon substancat radioaktive dhe reagentët për të përgaditur radiofarmakë duke ndjekur procedurat laboratorike.
- Vlerëson radiofarmakët e gatshëm duke përdorur instrumentet matëse dhe të analizave dhe pajisjet tjera siç është: jonizatori, analizatori me puls të lart, dhe kalibratorin dozues të radioizotopeve, të gjitha këto për tu siguruar se pacienti merr dozën adekuate dhe për të verifikuar shkallën e dezintegritetit të barit.
- Konsultohet me mjekët rreth rishikimit të procedurave të trajtimit të pacientëve dhe vlerësimit të kualitetit dhe efektivitetit të radiofarmakëve.
- Kryen hulumtime për zhvillimin apo përmirësimin e radiofarmakëve.
- Përgaditë raportet për agjencitë rregullatore për të siguruar pranimin e testimeve apo përdorimin e radiofarmakëve të rinj.
- Mirëmban dhe kontrollon të dhënat për recetat, procedurat e përgaditjes dhe ruajtjen mbetjeve radioaktive.
- Kryen sipas nevojës edhe trajnimin e studentëve dhe profesionistëve shëndetësorë në lidhje me përdorimin e radiofarmacisë, karakteristikat dhe procedurat përgaditore të radiofarmakëve.

Kushtet për Farmacist – Radiofarmacist:

- Të ketë të kryer Fakultetin e Farmacisë – Magjistër i Farmacisë dhe të jetë i licencuar në Odën e Farmacistëve të Kosovës,
- Përvoja e punës me Radiofarmakë, eluimin, lidhjen e izotopit me radiofarmakë dhe menaxhimin e tyre laboratorik është e preferuar,
- Përparesi kanë ata kandidatë që kanë Maxhistraturë, Studime Postdiplomike/Doktoratur, Punime shkencore në lëmin e Radiofarmacisë.
- Njohja e Gjuhës Angleze e preferuar

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidatit thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 kanë mbaruar shkollimin e duhur sipas këtij konkursi dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar për këtë pozitë.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038/512-667

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Çdo kandidat që aplikon dhe i plotëson kushtet sipas konkursit do t'i nënshtrohet testit më shkrim prej 100 poenëve. Kandidatët të cilët kalojnë 50 % të testit, fitojnë të drejtën të thirrjen për intervistim me gojë.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerzitetse Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universiteti Kliniçi Centar Kosova –
 University Clinical Center of Kosovo



Kadrovi Sektor

